



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:143053
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05766697
C.nr.1525/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.Th. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "....." L.L.C në Prishtinë, av. B.N. nga Prishtina, kundër të paditurës I.M.N. "....." Sh.p.k. Landovicë - Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim dëmi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me date 02.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.Th. nga fshati Komuna e Prizrenit dhe **DETYROHET** e paditura I.M.N. "....." Sh.p.k. Landovicë - Prizren, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, t'ia paguaj shumën e mjeteve si në vijim:

a) Dëmin jo material

- në emër të dhimbjeve fizike shumën prej..... 3,500.00 euro
- në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2,500.00 euro
- për shëmtim shumën prej3,000.00 euro
- në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej.....13,000.00 euro

Shuma të cilën është e detyruar e paditura I.M.N. "....." Sh.p.k. Landovicë - Prizren që të ia paguaj paditësit, në emër të dëmit jo material shumën e përgjithshme prej 22.000.00 (njëzetë mijë) euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (02.02.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

b) Dëmin material

-në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej..... 800.00 euro

-në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej..... 250.00 euro

-në emër të reh.fiziot. dhe klimaterik shumën prej..... 700.00 euro

- në emër të fitimit të humbur në formë të rentës mujore për periudhën 01.01.2015 deri më 31.07.2023, t'ia paguajë paditësit shumën prej **34,739.00 euro**, ndërsa për periudhën e ardhshme prej datës 01.08.2023, e deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore t'ia paguajë nga **400.00 euro** në muaj, pagesa e së cilës do të bëhet deri me datën 05 të muajit, për muajin në vijim.

të cilat shuma është e detyruar e paditura I.M.N. "....." Sh.p.k. Landovicë - Prizren që t'ia paguaj paditësit në emër të dëmit material, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 05.04.2016, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: për frikë shumën prej 500.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën 2,000.00 euro, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 100.00 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 50.00 euro, si dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimaterik shumën prej 560.00 euro, **si e pa bazuar.**

III. DETYROHET e paditura I.M.N. "....." Sh.p.k. Landovicë - Prizren, . që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë paditësit shumën prej **5,684.40 euro**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi M.Th. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqësojnë av. B.N. dhe A.D. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material dhe jo material, kundër të paditurve I.M.N. "....." Sh.p.k. Landovicë - Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, dhe Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë.

Në procesverbalin e datës 25.10.2021, gjykata ka marrë aktvendim me të cilët është ndërprerë procedura sa i përket të paditurës së dytë Kompania e sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë për shkak të procedurës së likuidimit.

Me aktgjykimin C.nr.373/16, të datës 16.05.2017, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar si dhe i ka detyruar të paditurat që t'ia paguajnë shpenzimet procedurale.

Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur me aktvendimin AC.nr.3736/2017, të datës 21.09.2020, e ka aprovuar ankesën si të bazuar dhe e ka prishur aktgjykimin e shkallës së parë me shenjen C.nr.373/16, të datës 16.05.2017 duke e kthyer lëndën në rigjykim dhe riprocedurë në shkallën e parë.

Gjykata pas pranimit të aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.3736/2017, të datës 21.09.2020, me qëllim të eliminimit të metave të vendimit të shkallës së parë dhe të për të zbatuar udhëzimet e Gjykatës së Apelit, ka caktuar seancën gjyqësore.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor i autorizuari e paditësit av. B.N. nga Prishtina, ka mbetur pranë padisë, kërkesës dhe theksimet nga seancat e kaluara. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë pretendimeve nga padia, respektivisht kërkesëpadija e precizuar me parashtrësën e datës 25.10.2023 dhe këtë si për sa i përket bazës juridike përmbledhjes së fakteve dhe provave të administruara, specifikimit të kërkesëpadiës sipas llojit të dëmit material dhe jo material që më detajisht ia ka dorëzuar gjykatës fjalës përfundimtare në formë të shkruar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumën e tërësishme prej 9,522.72 euro, në emër të azhurimit të çështjes 380.00 euro, përpilimit të padisë 406.25 euro, përfaqësimit në seanca gjyqësore në kontestin C.nr.373/16, dhe në kontestin C.nr.1525/20, 7,182.50 euro, për shpenzimet e udhëtimit 854.04 euro, taksës për padi 250.00 euro dhe për aktgjykim 250.00 euro, për ekspertiza mjekësore 450.00 euro dhe ekspertizës aktuaristike 250.00 euro. *(më gjerësisht si në fjalën përfundimtare të datës 02.02.2024, e cila gjendet në shkresat e lëndës).*

Edhe gjatë shqyrtimit kryesor i autorizuari i të paditurës së parë av. A.H. nga Prishtina, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, deklarimeve dhe parashtrësave të dorëzuara duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në këtë procedurë kontestimore ku shkelet në vazhdimësi obligimi ligjor esencial i gjykatës për vërtetim të drejtë të gjendjes faktike dhe atë me veprime administrative në drejtim të aprovimit të provave sekondare që i tejkalojnë në arsyetim të gjykatës provat thelbësore të institucioneve shtetërore, nuk pritet gjë tjetër është një zvarritje ligjore me zbatim të gabuar të gjendjes faktike dhe të drejtës materiale. Më tej ka deklaruar se mosrespektimi

i aktvendimit të Gjykatës së Apelit për vërtetim të drejtë të gjendjes faktike e që përballë provave materiale të institucioneve shtetërore nuk do të duhej të peshonte më shumë koha e shpejtë për të vendosur në çështjen konkrete sipas planit të kësaj gjykate e që është deri në vitin 2025. Është e qartë për të gjitha palët se çka do të rezulton në këtë aktgjykim marrë për bazë ikjen e gjykatës nga nxjerrja e provave për të cilat është e obliguar edhe exfficio pa propozimin e palëve të nxjerrë për qëllimin kryesor që ka kjo gjykatë vërtetimin e gjendjes faktike. Veprimet e gjykatës gjatë kësaj procedure me arsyetimin e çështjeve administrative periferike në raport me ato esenciale tregon më së paku vullnetin për të vepruar në drejtim të përfaqësimit të interesave të paditësit. Thirrja e gjykatës se si palë e procedurës nuk kemi paraqitur prova në kohën reale, respektivisht në shqyrtimin përgatitor nuk mund të jetë arsye ligjore e vetme për të anashkaluar veprimet procedurale-nxjerrjen e provave pas shqyrtimit përgatitor e që nuk është e ndaluar me LPK, për ta përmbushur obligimin e vetëm që kjo gjykatë ka me ligj dhe aktvendimin e Apelit-vërtetimin e gjendjes faktike të plotë dhe vërtetimin e veprimeve të palëve në procedurë në kohën kur edhe ka ndodhur aksidenti. Në fund ka deklaruar se një zvarritje të kësaj procedure, për faktin që tani kemi arsye të besojmë që këto anashkalime të gjykatës e që bien në favor ekskluziv të paditësit nuk janë të rëndësishme dhe me të pa drejtë, t'i jetojnë efektin juridik të vendimit që do të mirret. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: Raportin e Stacionit Policor në Prizren, të datës 28.04.2014; Raportin e emergjencës të lëshuar nga spitali rajonal në Prizren, me nr.8042, të datës 28.04.2014; Fletëdaljen e spitalit rajonal Prizren, me nr. 6935, të datës 15.05.2014, nga reparti ortopedik i të njëjtit spital; Fletë lëshimi nr.13001/14 nga Banja Oniks e Pejës, datë 28.12.2014; Raporti ortopedik i datës 29.05.2014 dhe 25.07.2014. nga spitali rajonal Prizren; Ekspertiza e ekspertit të ortopedisë dr.S.U. e datës 10.11.2016; Ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë Dr. V.B.R. e datës 10.11.2016; Ekspertiza e ekspertit të mjekësisë së punës Dr. A.H. e datës 12.05.2017; Ekspertiza dhe plotësimi i ekspertizës nga eksperti i aktuaristikës A.B. të datës 16.05.2017; Kontratën e punës të lidhur në mes IMNT Tulltorja dhe M.Th. të datës 06.01.2014; Çertifikatën për aftësimin profesional të lëshuar nga Qendra Rajonale për Punësim në Prizren, të datës 10.09.2014; Vendimin e inspektoratit të punës nr.71/14, të datës 07.05.2014; Raporti mjekësor dhe faturat lidhur me këto shpenzime të cilat janë administruar edhe nga ana e mjekëve - ekspertëve mjekësor; Policën për sigurim të përgjegjësive nr.600312, të lëshuar nga KS Kosova e Re, e datës 27.12.2013; Kërkesën në përgjithësi komunikimin në mes këtu të paditësit dhe palëve të paditura lidhur me shpërblimin e dëmit të datës 05.01.2015; Librin e kontributeve dhe tatimeve të lëshuar nga IMN Tulltorja për vitin 2014; Çertifikatën e

kohës së papunësisë, të lëshuar nga zyra komunale për punë dhe punësim, të datës 06.03.2017; Pasqyrën e llogarisë të lëshuar nga trusti pensional në emër të M.Th. për periudhën 01.01.2002 deri më 01.03.2017; Dëgjimi i deshmitarit Y.B. në seancën e datës 16.05.2017, si dhe është bërë dëgjimi i deshmitarit B.Sh. në seancën e datës 16.05.2017, ekspertizës për mbrojtje dhe siguri në punë e përpiluar nga Doc. Dr. Ing. H.N. me datë 09.05.2021, dëgjimin e ekspertit H.N. në shqyrtimin kryesor të datës 31.05.2021, ekspertizën e ekspertit për siguri dhe mbrojtje në punë Dr. Sc. A.K. të datës 28.06.2021, dëgjimin e ekspertit A.K. në shqyrtimin kryesor të datës, 13.07.2021 ekspertizën teknike të përpiluar nga ekspertët Ing. makin S.B. dhe N.Sh. i datës 24.11.2021, super ekspertizën e përpiluar nga eksperti R.G. të datës, 30.11.2021, sqarime plotësuese dhe konkluzionin e përbashkët të ekspertëve R.G., N.Sh. dhe S.B. e datës 13.05.2022, dëgjimin e ekspertëve N.Sh. dhe R.G. në shqyrtimin kryesor të datës 07.02.2023, dëgjimin e ekspertit S.B. në shqyrtimin kryesor të datës 13.03.2023, plotësimin e ekspertizave të datës 07.03.2017 dhe asaj të datës 16.05.2017, të përpiluar nga eksperti aktuar A.B. e datës 10.07.2023, dëgjimin e ekspertit A.B. në shqyrtimin kryesor të datës 10.11.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit M.Th. është pjesërisht e bazuar.

Pas vlerësimit të provave të administruara gjykata konstatojë se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se me datën 28.04.2014, në vendin e punës në ndërmarjen IMN" Tulltorja" sh.p.k Landovicë - Prizren, ka ndodhur aksidenti në vendin e punës dhe që në këtë aksident lëndime të rënda trupore me invaliditet të rëndë ka pësuar këtu paditësi M.Th.

Në mes palëve ndërgjyqëse ka qenë kontestuese pjesërisht baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadiës. Baza juridike me arsyetimin se e paditura e parë pretendon se kontribues në shkaktimin e aksidentit ka edhe vet paditësi, ndërsa e paditura e dytë pretendon se shkaktar të aksidentit janë e paditura e parë dhe paditësi. Mirëpo nga provat e administruara, e sidomos nga ekspertizat e nxjerrura gjykata ka vërtetuar faktin se këtu të paditurit në këtë procedurë janë shkaktar të aksidentit. Andaj sipas gjykatës nuk është kontestues fakti se e paditura është përgjegjëse në bazë të përgjegjësisë objektive, ndërsa e paditura e dytë në bazë të policës së sigurimit të lidhur me të paditurën e parë për rastet e punëtorve të siguruar, e në rastin konkret paditësi ka qenë punëtor tek e paditura e parë, andaj dhe për këtë të njëjtit kanë legjitimacion real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë.

Nga raporti policor i aksidentit, nr.2014-GA-1198, të datës 28.04.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se me datën e lartcekur ka ndodhur rasti - aksidenti në vendin e punës në fshatin Serbicë e ulët, me ç'rast edhe dy persona - punëtor kanë pësuar lëndime trupore. Si pasojë e këtij aksidenti, punëtori M.Th. merr lëndime të rënda trupore, lëndime të përshkruara nga ana e Spitalit Rajonal në Prizren.

Pasi që në mes palëve ndërgjyqëse siç u cek edhe më lartë ka qenë kontestuese edhe baza e kërkesëpadisë, mirëpo gjykata lidhur me këtë ka pasur në shkresat e lëndës edhe Vendimin e Inspektoratit të Punës në Prizren, me të cilin këtu të paditurës së parë i është dhënë masa ndëshkuese për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, ndërsa e paditura e dytë ka pasur të lidhur policën e sigurimit me të paditurën e parë për dëmet e shkaktuara palëve të treta, andaj lidhur me këtë kundërshtim të palëve të paditura nuk ka nxjerrë prova konkrete, pasi që edhe për këtë nuk kanë propozuar palët ndërgjyqëse.

Gjykata për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit sa i përket dëmit jomaterial të kërkuar sipas propozimit të palëve ka bërë nxjerrjen e provës përmes ekspertëve mjekësor, ekspertit të ortopedisë - traumatologjisë Dr .S.U. dhe ekspertit të psikiatrisë Dr. V.B.R.

Eksperti i ortopedisë-traumatologjisë Dr. S.U. pas ekzaminimit të drejtëpërdrejtë të paditësit dhe shkresave të lëndës, ka gjetur-konstatuar se paditësi M.Th. në këtë aksident - lëndim në punë, ka pësuar këto lëndime: lëndime trupore në të dy ekstremitetet e poshtme për të cilat lëndime është trajtuar në spitalin regjional në Prizren (reparti i ortopedisë). Në repart ka qëndruar prej ditës së lëndimit deri më 16.05.2014. në të njëjtën kohë posedon edhe raportet mjekësore kontrolluese të datës 29.05. dhe 25.07 të vitit 2014. Ka bërë rehabilitim dhe trajtim fizikal në banjë të Pejës nga data 19.12.2014 deri më 29.12.2014, kemi shikuar ekzaminimet radiologjike të kryera gjatë këtyre kontrollave (RTG) si dhe fotot e shputës dhe fotot e shputave të lënduara dhe nën gjurit të djathtëm, në bazë të gjitha këtyre të gjithave shënojnë këto diagnoza:Fraktura, cruris, lat.dextra, VLC pedisbill, Crash Syndroma ped bill. Intervenimet e kirurgjike të kryera në spitalin e Prizrenit, janë: Fiksimi dhe reporingu i kockës nën gjurin e djathtë me pllakë dhe vida, Përpunimi i plagëve të shkaktuara nga lëndimi si dhe fiksimi i gishtit të madhe të këmbës së majtë me një tel të Kirchnernt. Duke pasur parasysh të gjitha këto, raportet mjekësore, rentgenat dhe fotot, shënojmë se lëndimet karakterizohen si **lëndime të rënda trupore të rënda trupore**. Këto lëndime të e dëmtuara kanë shkaktuar: **I.** Dhimbje fizike - a) me intensitet posaçërisht të rëndë - rreth 30 sekonda; b) me intensitet të rëndë - 3 ditë (të cila kanë zgjatur deri të marrje të terapisë medikamentoze); c) me intensitet të mesëm - 3 javë tjera (koha e trajtimit në spital, operimi, pastrimi i plagëve, hekja e pejve), dhe d) me intensitet të ulët - ka ende dhe janë të shprehura në aktivitete fizike më të forcuara. **II.** Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor - Duke pasur parasysh lëndimet që ka pësuar pacienti, të cilat i

kemi shënuar më lartë, të cilat janë të dokumentuara në dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë, shënojmë se pacienti ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të shprehur në përqindje 22%. E arsyetuar në bazë të pika 213b. Lëvizshmëri e zvogëluar e zogut të këmbës së djathtë, shkalla e mesme 15%, (faqe 139), lëvizshmëri e zvogëluar e këmbës së majtë shkallë e ulët 10%, pika 213a, (faqe139), si dhe shtagim i nyjës distale të gishtit të madhe pika 223 2.5%, (faqe 139), të gjitha këto të sqaruara në librin mjekësia ligjore autorët Dr.S.M. edhe F.B. Sqarim, llogaritja është bërë në këtë mënyrë, vlera e parë më e madhe që është 15% + gjysma e vlerës së dytë 5% si dhe 2% nga gishti i këmbës së majtë, rezultati 22%. **III.** Në inspeksion gjegjësisht gjatë ekzaminimit klinik të pacientit kemi vërejtur shenjat (cikatrikset postoperative) nën gjurin e djathtë me gjatësi rreth 15cm., plagë (cikatrikst në të dy shputat) me gjatësi rreth 10cm. Të gjitha këto pacientit i shkaktojnë shëmtime trupore të shkallës së mesme, që njëkohësisht janë të plotësuara edhe me zvogëlim të lëvizshmërisë të dy nyjeve të dy shputave. **IV.** Ndiqja e personit të tretë ka qenë e nevojshme - për rreth 3 muaj tjerë deri kur pacienti ka filluar të përdor për shkelje në peshë më të madhe këmbën e majtë, gjithmonë me paterica. Nëse pllaka e cila është në këmbën e djathtë shkakton pengesa funksionale, atëherë rekomandohet heqja e saj, pasi që e njëjta ende nuk është e hequr nga këmba e operuar të dëmtuarit. **V.** Ushqimi i përforcuar - Pacienti ka pasur nevojë për ushqim të forcuar dhe atë në formë të proteinave dhe vitaminave për rreth një muaj, për shkak të nevojës për rritje të forcave mbrojtëse të organizmit në mënyrë që më lehtë të reziston dhe përballon lëndimet trupore. **VI.** Rehabilitimi fizioterapeutik-klimatik - Pacienti ka nevojë për trajtim dhe rehabilitim fizikal për të bërë preventivën e rritjes së kontrakturës së nyjeve (gjegjësisht zvogëluar mërisë të lëvizjes së nyjeve) dhe atë tri vitet e ardhme një herë në viti nga 2 javë. Konstatimit të tillë të ekspertit ortoped Dr.Skender Ukaj, kjo gjykatë ia fali besimin.

Sa i përket shkallës së frikës së përjetuar, eksperti i lëmis psikiatrike Dr.V.B. R. ka deklaruar se bazuar në dokumentacionin mjekësor i cili ekziston në shkresat e lëndës si dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të dëmtuarit - paditësit M.Th. në aksidentin - lëndimin në punë, të datës 28.04.2014, ka përjetuar: Frikë primare - që ka zgjatur disa sekonda prej momentit kur makina i ka përfshirë ekstremitet e poshtme e deri te momenti kur këto ekstremitete janë liruar plotësisht, kjo frikë cilësohet si frikë nga përfundimi fatal apo nga vdekja. Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur rreth 24 orë, si pasojë e reaksionit akut në strese e përcjellur me ankthe, reagime të forta emocionale dhe frikë nga invaliditeti i mundshëm. Frika sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur rreth 2 muaj, fillimisht me vështësi rreth adaptimit në kushte të trajtimit spitalor ku hyn periudhat operative, përpunimi i plagës, trajtimet dhe tretmanët e shumta mjekësore, gjendje kjo që te i dëmtuari ka shkaktuar iritabilitet, zgjimet e shpeshta gjatë natës për shkak të pozitës së detyruar në shtrat, ulje të pragut të tolerancës, ulje të vullnetit të disponimit dhe shqetësim se mos këto pasoja do të mbesin për tërë jetën (bazuar edhe në moshën e re të të dëmtuarit). Frika sekondarë e intensitetit të ulët, vazhdon ende, herë pas here me qenë se i njëjti ende ndien probleme

dhe dhembje në ekstremitete të poshtme gjatë funksionimit të përgjithshëm jetësor si dhe gjatë aktiviteteve reaktive dhe sportive, kjo e bënë që të rikujtojë momentin e aksidentit të ndiej ankth dhe pasiguri për gjendjen e tij shëndetësore. Ky është mendimi im për frikën dhe intensitetin e saj. Konstatimit të tillë të ekspertit psikiatër dr.N.F. kjo gjykatë gjithashtu ia falë besimin.

Sa i përket zvogëlimit të aftësisë punuese të paditëses gjykata ka marrë mendimin e ekspertit të mjekësisë së punës Dr. A.H. nga Prishtina, i cili në mendimin e tij ka theksuar se: paditësi M.Th. me moshë 32 vjeçare, kualifikim saldues, para aksidentit i punësuar në ndërmarrjen Tulltorja, si punëtor mekanik (mirëmbajtës) i orientuar në kohë dhe hapësirë me shikim dhe dëgjim të ruajtur me lëvizje të qafës dhe të gjitha drejtimet me lëvizje të gjymtyrëve të sipërme të ruajtura me forcë motorike në dy duart të ruajtur me pengesë në ulje (quqje) dhe ngritje lehtë të penguar nga dhimbja e kyqit dhe gjunjëve me ecje në rrafsh të ruajtur me lëvizshmëri të shputave të këmbës të kufizuara sidomos e majta në fleksion (lakim) të shputës në rotacion të jashtëm të shputës me dhimbje dhe kontaktuar të theksuar në gishtin e majtë të shputës së majtë, me shenja cikatrix ose vrraja të dukshme në pjesën plantare të shputës së majtë në gjatësi prej 10cm. Afërsisht, gjurmë e lëndimit dhe intervenimit kirurgjikal, në prezencë osteosintezës metalike nën gjurin e djathtë, me kontrakturë të theksuar, nën një talokrurale të djathtë, me dhimbje të përhershme gjatë ecjes sidomos ecjes së gjatë dhe qëndrimit të gjatë në këmbë, andaj në bazë të të gjitha që u cekën më lartë konstatojë se te z. M.Th. kemi pasur lëndime të rënda trupore në aksidentin në vendin e punës që akoma pasojat janë prezentë dhe mund të pritet intervenim kirurgjikal dhe nën gjurin e djathtë dhe mendimi im për aftësinë e mbetur për punë në profesionin e tij është e kufizuar, për shkak se do të ketë pengesa evidente në qëndrim e gjatë në këmbë, aftësia për punë të rënda fizike si ngritja e peshës së rëndë, vrapimi, qëndrimi i gjatë në këmbë dhe aktivitet tjera fizike janë të zvogëluara në shkallë prej 60%, gjersa aftësia për punë për punën që e ka bërë është e zvogëluar në vlerë prej 30%. Pasojat e lëndime të këmbës sidomos të djathtë mund të ndryshojnë varësisht nga vlerësimi i ortopedit a do të ketë ndërhyrje prapë apo jo në të ardhmen. Poashtu edhe në plotësimin e ekspertizës së datës 12.05.2017, eksperti ka theksuar se aftësia e përgjithshme për punë (e përhershme dhe definitive), pas aksidentit në vend pune të datës 28.04.2014 është e zvogëluar për 30% , si pasojë e këtyre lëndimeve nga ky aksident, në të njëjtën punë, qëndrimi i gjatë në këmbë, ulje dhe ngritje të trupit me dhimbje, pengesa në kufizim të lëvizjeve të shputave e sidomos në këmbën e majtë, vështirësi të përshtatjes së trupit në pozita të dhunshme gjatë punës së këtij profesioni, mund të mos ketë stabilitet për shkak të dhimbjeve dhe pengesave të lëvizshmërisë së gjymtyrëve të poshtme, paditësi konsiderohet si i paaftë 100% për aftësi punuese profesionale (saldues).

Gjithashtu, gjykata ka marrë edhe mendimin e ekspertit financiar - aktuarit lidhur me vlerësimin e dëmit për shkak të fitimit të humbur, i cili në mendimin dhe konstatimin të cilin gjykatës ia ka parashtruar me shkrim si dhe plotësimin e saj të datës

07.03.2017, ka konstatuar se paditësi në momentin e aksidentit ka qenë me profesion saldues dhe duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të mjekësisë së punës ku paditësi për të ushtruar këtë profesion ka zvogëlim të aftësisë punuese prej 100 % , ka theksuar se paditësit prej datës 01.01.2015 prej kur i është ndërprerë paga (jo prej datës së aksidentit 28.04.2014), deri më datën 28.02.2017 i takon kompensimi në emër të rentës në shumën prej 9,101.33 euro. Ndërsa për periudhën pas kësaj date e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore shumën prej 332.72 euro. Vlen të ceket se kundër të gjitha mendimeve dhe konstatime të ekspertëve të lartcekur asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk kanë bërë vërejtje.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit Y.B. nga Gjakova, i cili ka theksuar se “Puna në këtë makinë bëhet në 2 ndërrime, për të cilën ekzistojnë manipuluesit – punëtorët e autorizuar të cilët të njëjtën e dirigjojnë nga vendi i tyre i punës dhe i cili ka shiritat transportues. Por, është një ndihmës – manipulues ose pastruesi i vijës (dheu çka derdhet e pastron pastruesi) dhe një mekanikë – mirëmbajtës i makinave. Detyra e M. ka qenë për mirëmbajtjen e makinave. M. e ka njohur punën e tij, pasi që i njëjti ka qenë pjesëmarrës edhe në montimin dhe lëshimin në punë të fabrikës. Kur bëhet pastrimi, patjetër duhet të njoftohet manipuluesi dhe makina duhet të jetë e ndalur pjesërisht. Ditën kritike, nuk kam qenë, pasi që unë jam drejtor i prodhimit, dhe jam njoftuar nga punëtorët dhe kur kam shkuar në vend të njëjtit veç i kanë nxjerr nga makina. Udhëzimet për përdorimin e këtyre makinave, janë të lëshuar në letër, dhe nuk mund të lëshohet makina e dytë pa u lëshuar makina e parë”.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit B.Sh. nga fshati i cili ka theksuar se “Ditën kritike ka qenë duke punuar bashkë me M.Th. dhe pasi që kanë pasur problem me makineri dhe kanë qenë duke rregulluar disa punëtor tjerë edhe unë bashkë me M. kemi pasur një defekt në kolergang, dhe pasi që M. ka qenë mekanik dhe unë kam qenë punëtor në të edhe ne kemi hy që të rregullojmë defektin dhe sa kemi qenë brenda është lëshuar në punë makina pasi që kemi harruar ti njoftuar se jemi duke i rregulluar edhe ne makinat dhe në këtë mënyrë ka ardhur deri te lëndimi. Kemi pas për obligim që ta njoftojmë manipuluesin e pultit, mirëpo kemi harruar që të njoftojmë. Detyra ime ka qenë që ti ndihmojë mekanikut, që të pastrojë dheun në makinë. Më kujtohet se atë ditë nuk ka punuar sensorin i cili e ndërprente makinën për aktivizim, dhe i njëjti nuk ka punua edhe 10 ditë më përpara dhe ka qenë rast i njoftuar për rregullimin e saj. Në cilësinë e pozitës që e kam pasur pastrimin e dheut, ka qenë detyra ime me lajmëruar dikën për sensorin për rregullimin e pajisjes. Unë kam qenë ndihmës i M. mirëpo me urdhërat e shefit të ndërrimit, i cili nuk më kujtohet cili ka qenë atë ditë. Të gjitha urdhëratë janë dhënë me gojë. Kemi hy të rregullojmë maqinën pasi që kemi menduar se deri sa ta rregullojmë ekipa tjetër maqinën tjetër edhe ne do të mund ta rregullojmë të njëjtën. Asnjëherë nuk kemi hy pa lajmërua, por vetëm atë ditë. Nuk e di kush ka qenë duke e rregulluar makinën tjetër atë ditë. Në momentin e hyrjes në makinë, duhet të jetë

e ndezur shenja ndriqese në momentin e punimeve në makinë, por nuk ka qenë e ndezur dhe për të njëjtën ka qenë kompetentë manipuluesi”.

Nga leximi i ekspertizës për mbrojtje dhe siguri në punë e përpiluar nga Doc. Dr. Ing. H.N. me datë 09.05.2021, ka konstatuar se gjatë bisedës me paditësin lidhur më lëndimin e tij, ka vërejt se ky punëtor nuk ka pas njohuri nga programi për vlerësimin e rreziqeve, me që nuk ka pas kujdes për ta kryer punën në mënyrë të sigurt. Në rastin konkret, në momentin kur e ka të nevojshme dhe ka vendos për ta pastruar mullirin, nuk ka ditur me vlerësuar këtë faktor se a janë marr të gjitha masat e sigurisë, andaj edhe ka ndodhur që në rrethana të tilla mulliri të kyqet nga pullistit duke përfunduar me lëndimin e dy punëtorëve. Më tej ka theksuar se shikuar ka aspekti i sigurisë nga njohurit që do t'i kishte marrur dhe po t'i ishin dhënë udhëzime paditësit nga programi i vlerësimit të rreziqeve dhe nga trajnimi i tij me nënshkrim të punëtorit se për të kryer punën e vet në mënyrë të sigurt gjatë pastrimit të mullirit punëtori, patjetër është dashur të i përmbahet rregullave të sigurisë dhe patjetër do të kishte qenë i obliguar që për ta kryer punën në mënyrë të sigurt që të kontrolloj me siguri të plotë se pullisti apo dikush tjetër nuk mund ta kyq mullirin sepse njohurit e marrura në trajnim nga dokumenti i vlerësimit nëse do të lëndohej atëherë në atë rast paditësi M.Th. do të kishte qenë vet përgjegjës për lëndimin e tij. Pra përmes vlerësimit të rreziqeve dhe identifikimit të tyre në vendet e punës IMN “Tulltorja” të organizuar nga ana e punëdhënësit, paditësi do të kishte vepruar në përputhje me udhëzimet të cilat i ka pranuar (me nënshkrimin e tij) për të përkujdesur për vetëvehten dhe punëtorët e afërt, duke u sugjeruar që të veprojnë në përputhje me rregullat e sigurisë në punë dhe nuk do të kishte ardhur deri të ky lëndim. Kjo kompani si punëdhënëse nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për t'i përmbushur detyrimet lidhur me ndërmarrjen e masave të nevojshme për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë përmes vlerësimit të rreziqeve në vendet e punës, identifikimit të rreziqeve, ofrimit të informatave, dhënien e udhëzimeve dhe masave të duhura për punë të sigurt. Eksperti ka ardhur në përfundim se nuk kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi ka qenë i detyruar të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, që përfshin masat për parandalimin e rreziqeve profesionale dhe dhënien e udhëzimeve të duhura për punë të sigurt sipas dispozitave të Ligjit të Sigurisë në Punë. Punëdhënësi ka qenë i detyruar të zbatoj masat parandaluese, bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit, andaj rezulton se duhet të mbanë përgjegjësin bazuar në detyrimet dhe parimet e përgjithshme të punëdhënësit të cekura në këtë konstatim, Ndërsa nga detyrimet e të punëmarrësit sipas nenit 21 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë çdo i punësuar ka përgjegjësi të përkujdeset për sigurinë dhe shëndetin e vet dhe të personave tjerë në punë në përputhje me trajnimin dhe udhëzimet që i janë dhënë nga punëdhënësi, por me që nga punëdhënësi nuk ka pasur trajnim nga siguria në punë dhe udhëzime të duhura, rezulton se punëmarrësi nuk mund të ketë asnjë përgjegjësi për lëndimin e vet.

Gjithashtu, gjykata ka marrë edhe mendimin e ekspertit për siguri dhe mbrojtje në punë Dr. Sc. A.K. i cili në mendimin e tij pikën 1 ka theksuar se punëdhënësi, respektivisht përgjegjësit e këtij reparti nuk kanë organizuar punën e rregullimit të pastruesëve të makinës Kollergang "Handle" si duhet nga aspekti i sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Eprori i punëtorit të lënduar do të duhej të merrte masat informuese dhe veprime konkrete për sigurimin që makina ku janë futur punëtorët për të vepruar në hapësirën e brendshme të makinës të mos ketë mundësi të lëshohet në punë nga askush. Punëdhënësi nuk ka ndërmarrë masat teknike plotësuese që përmes senzorit (mikrondërprerësit) të çkyqet makina dhe të mos ketë mundësi të aktivizimit të saj deri sa dera e hapësirës përzierëse është hapur. Meqenëse rotor i makinës është vënë në funksion deri sa dera ka qenë e hapur kjo tregon se mikrondërprerësi ka qenë jashtë funksionit (në defekt ose i eliminuar nga funksioni). Në vazhdim ka theksuar se punëdhënësi nuk ka bërë trajnimin e punëtorit nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Edhe pse punëtori ka një certifikatë interne, kjo nuk është plotësisht e njëjtë me certifikatën nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Punëdhënësi nuk ka dërguar në kontrollim mjekësor punëtorin M.Th. para se t'a angazhoj në punë në mënyrë që të konstatohet gjendja e tij shëndetësore a lejon kryerjen e atyre punëve në mënyrë të sigurt. Punëdhënësi nuk ka instaluar në veprimtarinë e kompanisë së vet rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë në nivel të duhur. Në pikën 2 ka theksuar se punëtori ka pësuar lëndim trupor pasi që ka hyrë në hapësirën rrotulluese të rotorit të makinës për arsye të rregullimit të pastruesit të saj dhe për këtë nuk ka ndërmarrë masat e duhura nga siguria dhe mbrojtja në punë, por ka rrezikuar veten dhe punëtorin tjetër. Punëtori meqenëse ka qenë me profesion mekanik, ka pasur një përvojë pune relativisht të gjatë në këtë vend pune, ka pasur njohuri për konstruksionin dhe mënyrën e funksionimit të kësaj makine, si rrjedhojë ka ditur edhe rreziqet eventuale. Prandaj para se te futet në makinë ka qenë i obliguar t'i informoj të tjerët, posaçërisht pullistin A.B. e nga deklarata e vetë punëtorëve shihet se nuk e kanë informuar pullistin. Meqenëse punëtori M.Th. ka qenë i angazhuar në detyrat e punës për mirëmbajtje të makinave, ka qenë i obliguar të ndërmarr masa për rregullimin e mikrondërprerësit të derës nëse i njëjti ka qenë në defekt ose të mos lejoj eliminimin e funksionit të tij përmes ndonjë veprimi, prandaj në bazë të asaj që u tha më sipër, mendon se përgjegjësia për rastin e lëndimit të punëtorit M.Th. është e përbashkët, respektivisht e punëdhënësit dhe e punëmarrësit.

Me leximin e ekspertizës teknike (super ekspertizës) e përpiluar nga ekspertët Ing. makin. S.B.dhe Ing. makin. N.Sh. i datës 24.11.2021, konstatohet se sa i përket faktorëve makinerikë në rastin konkret, makina punuese e markës Handle Kollergang tip HKS v.p. 1966, në momentin e shkakimit të aksidentit, lëndimt të punëtorit të I.M.N. "Tulltorja" Sh.p.k. në Landovicë, të shkakuar me datën 28.04.2014, nuk janë shkakuar të lëndimeve të punëtorit.

Nga leximi i super ekspertizës i përpiluar nga eksperti gjyqësor R.G. inxh. i datës 30.11.2021, janë konstatuar dështimet e punëdhënësit nga aspekti i sigurisë dhe

shëndetit në punë lidhur me lëndimin në punë ta paditësit M.Th. bazuar në kërkesat e dala nga Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë të Kosovës nr.04/L-161, kompania në fjalë nuk ka arritur që t'i vetëdijsojë të punësuarit për veprimet e tyre, që mund të jenë me pasoja për shëndetin e tyre gjatë procesit të prodhimit dhe është dashur që medoemos të investojnë më shumë në ngritjen e nivelit të diturisë të sigurisë dhe shëndetit në punë, veçanërisht në realizimet e parimeve të përgjithshme të punëdhënësit neni 5, detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit neni 6, masat parandaluese neni 7, vlerësimi i riskut për vendin e punës neni 16 par.1, udhëheqjes se evidencës së lëndimeve në punë, lëshimeve të fletëlëndimeve në punë neni 16 par.5, trajnimeve nga siguria dhe shëndeti në punë neni 20, përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) neni 21, kontrollimeve mjekësore neni 22, si dhe dispozitave 3, 4 dhe 5 të nenit 42 të Ligjit të Punës së Kosovës. Ndërsa sa i përket dështimeve të punëmarrësit ka konstatuar mos kujdesja për sigurinë e vet dhe të pastruesit B.Sh. hyrja e pa informuar pultistin A.B. të paditësit M.Th. në kolergang së bashku me B.Sh. për riparim dhe pastrim neni 21, të njoftoj menjëherë punëdhënësin, personin e ngarkuar për siguri në punë dhe përfaqësuesit e të punësuarve si rast që paraqet rrezik të rëndë të menjëhershëm për siguri në punë, për të dy rastet e sensorit neni 21 dispozita 2.4, të respektoj të gjitha detyrimet e përcaktuara nga punëdhënësi nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë neni 21 dispozita 2.5, i punësuarit të lajmëroj inspektoratin e punës, nëse punëdhënësi nuk i ka ndërmarrë masat përkatëse neni 21 dispozita 3. Më tej ka theksuar se bazuar në nenin 21 para.1, 2.4, 2.5, 3 dhe 4, detyrimet e të punësuarit të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë të Kosovës 04/L-161, paditësi M.Th. kishte me qenë përgjegjës për dështimet e shënuara më lartë, por bazuar në nenin 7 par.1.11, lidhur me udhëzimet për punë të sigurt në vend të punës, kompania në fjalë nuk ka evidencë me shkrim se i ka dhënë paditësit M.Th. për punë të sigurt në vendin e punës mekanik, bazuar në nenin 20 par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, lidhur me trajnimet për punë të sigurt në vendet e punës, kompania në fjalë nuk ka evidencë me shkrim se ditën kritike ka qenë trajnuar paditësin M.Th. për punë të sigurtë në vendin e punës mekanik. Në fund sa i përket përgjegjësië ka theksuar se e paditura kompania I.M.N. "Tulltorja" Sh.p.k. lidhur me lëndimin e paditësit M.Th. mban përgjegjësi primare, ndërsa paditësi M.Th. mban përgjegjësi sekondare.

Nga leximi sqarime plotësuese dhe konkluzione të përbashkëta të grupit të ekspertëve R.G., N.Sh. dhe S.B. e datës 13.05.2022, gjykata ka vërtetuar se ekspertët gjyqësor të lëmis së makinerisë N.Sh. dhe S.B. kanë mbetur në tërësi pranë gjetjeve dhe konstatimeve nga raporti i dorëzuar i ekspertizës i datës 24.11.2021 për sa i përket analizës dhe konstatimeve me përshkrim të performancës teknike dhe funksionimit të makinës punuese të markës Handle Kollergang Typ HKS 1966 pranë të paditurës I.M.N. "Tulltorja" Landovicë, përpos pjesës e cila i referohet segmentit të pajisjeve të sigurisë në këtë makinë pune. Andaj raporti i ekspertizës datë 24.11.2021, plotësohet në gjendjen faktike të funksionimit të makinës Handle Kollergang Typ HKS 1966 në momentin e incidentit në punë, mbështetur në konstatimet paraprake nga ekspertiza e ekspertit H.N. ekspertiza e ekspertit A.K. si dhe shikimit në vend të ngjarjes nga ana e tyre, me ç'rast

është evidente se në këtë makinë pune ishin realizuar intervenime në kundërshtim me manualet/udhëzuesit e prodhuesit Handle&Sohn. Këto intervenime i referohen furnizimit me energji elektrike të derës së makinës së punës përmes një urëzimi jo profesional që kishte për pasojë eliminimin e funksionimit të sensorit i cili kontrollon automatikisht hapjen/mbylljen e derës së kësaj makine dhe me këtë sigurinë në punë gjatë përdorimit. Duke pasur parasysh këtë fakt, intervenimi përkatës rezultoi si shkak determinant për incidentin funksionimi Handle Kollergang Typ HKS 1966 me mangësi të elementit të sigurisë/sensorit. Po ashtu e eksperti nga lëmia e sigurisë në punë R.G. mbetet pranë gjetjeve dhe konstatimeve nga ekspertiza e datës 30.11.2021 dhe bazuar në gjendjen faktike të funksionimit të makinës Handle Kollergang Typ HKS 1966, mbështetur në gjetjet dhe konstatimet e ekspertëve të profilit të makinerisë të përshkruara në pikën 1 më lartë, e cila nga shkresat e lëndës nuk del të jetë provuar ndryshe nga punëdhënësi. Mbi gjendjen e fakteve të analizuar me raportet e dy ekspertizave, ka mbetur pranë konkluzioneve përkitazi me dështimet në zhvillimin e procesit të punës të precizuara në faqen 9 të raportit të të ekspertizës të datës 30.11.2021, duke nënvizuar kësaj radhe që ndan mendimin e përbashkët përkitazi me shkakun determinant të këtij incidenti në punë e që i referohet dështimit të mirëmbajtjes së makinës së punës (mos funksionimi i sensorit të derës së Kolegramit të pajisjes Handle Kollergang Typ HKS 1966-mullirit për bluarjen të dheut) i cili ishte shkak i drejtpërdrejt i incidentit në punë të datës 28.04.2014.

Nga leximi i plotësimit të ekspertizave të datave 07.03.2017 dhe asaj të datës 16.05.2017, i përpiluar nga eksperti aktuar A.B. të datës 10.07.2023, i njëjti ka rikonstatuar se duke marrë për bazë njëjtën pagë gjatë gjithë periudhës së kaluar prej 01.01.2015 e deri më 31.07.2023, kur po e konsiderojmë si datë të kryerjes së kësaj ekspertize dhe invaliditetin e tij punues prej 100 % të vlerësuar nga eksperti i mjekësisë së punës, të cilin proporcion nga paga të cilën do ta realizonte ai po të mos aksidentohej prej së paku asaj të kontraktuar prej 332.72 euro, del se fitimi i humbur-renta e arritur për pagesë e tij arrinë në lartësi: për periudhën jo prej aksidentit 28.04.2014, por prej 01.01.2015, prej kur i është ndërprerë paga atij nga punëdhënësi-tani i padituri i parë e deri më tani 31.07.2023 renta e arritur për pagesë arrin 34,739 euro dhe për periudhën e ardhshme prej 01.07.2023, e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore duke supozuar se kjo pagë mujore 332.72 euro, paditësit deri më tani do t'i ngritej së paku konform faktorëve inflator-ngritjes së çmimeve me pakicë dhe ngritjes mesatare të ardhurave personale në Kosovë gjatë këtyre mbi 7 viteve të kaluara prej 01.05.2015 e deri më tani 31.07.2023, në 400 euro dhe të njëjtën duke marrë për bazë me rastin e llogaritjes së rentës mujore të paditësit gjatë periudhës së ardhshme, del se renta e ardhshme prej 01.08.2023, e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore do të duhej të ishte nga së paku nga 400 euro në muaj. Në qoftë se palët kontestuese dakordohen që për periudhën e ardhshme prej 01.08.2023 e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore kjo rentë paditësit të aksidentuar t'i paguhet në formë të menjëhershme-të kapitalizuar, atëherë duke aplikuar tabelat e mortalitetit të aplikueshme në Kosovë për meshkuj dhe kamatën prej 3% në vit, del se

shuma e kapitalizuar e saj deri më 26.02.2050, kur ai do t'i plotësonte 65 vjet, deri kur konsiderohet se i njëjti do të ishte i aftë për ekonomizim dhe në kushte normale dhe po të ishte i punësuar me detyrim ligjor do të pensionohej do të jetë 86,256 euro. Pra shuma e gjithmbarshme e rentës për periudhën e kaluar dhe për periudhën e ardhshme e paguar në formë të kapitalizuar arrin vlerën $34,739+86,256=120,995$ euro.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara e sidomos mendimit dhe konstatimit të ekspertëve mjekësor dr. S.U. - ortoped-traumatolog, dr.V.B. R.-psikiatër, e të cilave mendime gjykata në tërësi ia fali besimin, pasi që mendimet e tyre i dhanë në mënyrë profesionale dhe objektive dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit M.Th. është e bazuar ashtu siç është aprovuar në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që lartësia e aprovuar në emër të të gjitha llojeve të dëmeve materiale dhe jomateriale është adekuate me lëndimet e pësura të paditësit e të cilat gjykata i caktoi sipas bindjes së lirë konform nenit 323 të LPK-së si dhe duke pasur si orientim kriteret dhe masat e përcaktimit të lartësisë së dëmeve materiale dhe jo materiale të përcaktuara nga kompanitë e sigurimeve.

Baza Ligjore

Baza juridike e kërkesëpadiës së paditëses gjen mbështete në dispozitat e nenit 136, 137, 154, 155, 179 par.1, 183 par.1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e po ashtu edhe nenet 2.1 dhe 2.10 të Ligjit për Siguri në punë, mbrojtje të Shëndetit dhe Ambientit të Punës.

Me nenin 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa me nenin 137 të këtij ligji parashihet se *“Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*. Me nenin 154 të po këtij ligji është paraparë se *“Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”*. Ndërsa në nenin 155 të LMD-së është paraparë se *“Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të”*. Me nenin 172 par.1 të LMD-së ku në mënyrë decisive ceket se *“Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar”*. Në nenin 179 par.1 të këtij ligji parashihet se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë që të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitim e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”*. Po ashtu në nenin 183 par. 1 të këtij ligji parashihet se *“Për dhembjet e pësura fizike, për dhembjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të*

shëmtimit, të cënimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”, ndërsa në par.2 të po këtij neni është paraparë se “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cënimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë se me të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Ndërsa me nenin 2.1 të Ligjit për Siguri në punë, mbrojtje të Shëndetit dhe Ambientit të Punës, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të aksidentit, është paraparë se **“Punëdhënësi është i obliguar që të sigurojë kushtet për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës për punëmarrësit e tij/saj. Punëdhënësi është i obliguar për ti mbuluar të gjitha shpenzimet për kurimin e të lënduarve në punë dhe sëmundjeve profesionale.....”**. Ndërsa në nenin 2.10 të po këtij ligji është paraparë se **“Punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar në punë me rastin e lëndimit në punë dhe sëmundjen profesionale që kanë të bëjnë me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve”**.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pas vlerësimit të provave të administruara gjykata konstatojë se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se me datën 28.04.2014, në vendin e punës në ndërmarjen IMN” Tulltorja” sh.p.k Landovicë - Prizren, ka ndodhur aksidenti në vendin e punës dhe që në këtë aksident lëndime të rënda trupore me invaliditet të rëndë ka pësuar këtu paditësi M.Th.

Në mes palëve ndërgjyqëse ka qenë kontestuese baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë. Baza juridike me arsyetimin se e paditura e parë pretendon se kontribues në shkaktimin e aksidentit ka edhe vet paditësi. Mirëpo nga provat e administruara, e sidomos nga ekspertizat e nxjerrura gjykata ka vërtetuar faktin se këtu të paditurit në këtë procedurë janë shkaktar të aksidentit. Andaj sipas gjykatës nuk është kontestues fakti se e paditura është përgjegjëse në bazë të përgjegjësisë objektive.

Në bazë të lartcekurave gjykata ka vërtetuar se e paditura e parë është përgjegjëse ndaj këtu paditësit konform përgjegjësisë objektive, të parashikuar me dispozitat e lartcekura të nenit 173 dhe 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e po ashtu edhe në bazë të fajësisë të paraparë sipas nenit 136 dhe 137 të LMD-së, dhe dispozitave mbi kompensimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin material të shkaktuar, e të parapara me dispozitat e nenit 179 të LMD-së, si dhe dëmit jo material konform nenit 183 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke u bazuar në udhëzuesin e Gjykatës

Supreme të Kosovës të datës 27.02.2023, për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material.

Në lidhje me lartësinë e kërkesave të aprovuara sikurse në shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata konstaton se të njëjtat janë adekuate, e gjithë kjo duke u bazuar në lëndimet e pësuar nga paditësja si pasojë e aksidentit të shkaktuar. Duke u bazuar në ekspertizën e ortopedisë - traumatologjisë të përpiluar nga eksperti ortoped-traumatolog Dr. S.U. gjykata ka vërtetuar faktin se lëndimet e paditësit janë lëndime të rënda trupore. I dëmtuari në këtë rast paditësi ka pësuar Fraktura, cruris, lat.dextra, VLC pedisbill, Crash Syndroma ped bill. Intervenimet e kirurgjike të kryera në spitalin e Prizrenit, janë: Fiksimi dhe reporimi i kockës nën gjurin e djathtë me pllakë dhe vida, Përpunimi i plagëve të shkaktuara nga lëndimi si dhe fiksimi i gishtit të madhe të këmbës së majtë me një tel të Kirchnernt. Nga momenti i aksidentimit e deri në fillimin e mjekimit i aksidentuari ka pësuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të lartë rreth 30 sekonda, dhimbje fizike me intensitetit të lartë rreth 3 ditë, e cila ka zgjatur deri në marrje të terapisë medikamente, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm rreth 3 javë tjera (koha e trajtimit në spital, operimi, pastrimi i plagëve, hekja e pejve), ndërsa dhimbje fizike të intensitetit të ulët pacienti ka ende dhe janë më të shprehura në aktivitete më të forcuara. Si pasojë e lëndimeve të marra te paditësi janë vërejtur shenjat (cikatrikstet postoperative) nën gjurin e djathtë me gjatësi rreth 15 cm, plagë (cikatrikst në të dy shputat) me gjatësi rreth 10 cm, të cilat paditësit kanë shkaktuar shëmtime trupore të shkallës së mesme, që njëkohësisht janë të plotësuar edhe me zvogëlim të lëvizshmërisë të dy nyjeve të dy shputave. Paditësi kishte pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën 22%, po ashtu paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për rreth 3 muaj, ushqim të përforcuar në kohëzgjatje rreth 1 muaj dhe rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimaterik për të bërë prevetivën e rritjes së kontrakturës së nyjeve (gjegjësisht zvogëlueshmërisë të lëvizjes së nyjeve) ka qenë i nevojshëm dhe atë 3 vitet e ardhshme 1 herë në vit nga 2 javë. Lëndim ky i përshkuar detajisht në ekspertizën e ekspertit ortoped Dr. S.U. po ashtu gjykata duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të mjekësisë së punës të përpiluar nga eksperti Dr. A.H. ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur zvogëlim të aftësisë punuese në shkallë 100% (për punë e vet profesionale). Gjukata ekspertizave ia fali besimin e plotë, pasi që gjykata gjeti se ekspertizat janë përpiluar në mënyrë profesionale nga ana e ekspertitëve të lartpërmendur, ngase mendimi i tyre përputhet në tërësi me raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës me gjendjen reale të dëmtimeve që i kanë vërtetuar me rastin e shiqimit të drejtëpërdrejtë të paditësit. Për këtë ekspertizë, vlen të ceket se palët nuk kanë pasur vërejtje.

Po ashtu është vërtetuar se paditësi në aksidentin e ndodhur kishte përjetuar disa lloje të frikës, të cilat janë përshkuar nga ekspertja e psikiatrisë Dr. V.B.R. në ekspertizën e saj, e që më saktësisht ka konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka përjetuar frikë primare - që ka zgjatur disa sekonda prej momentit kur makina i ka

përfshirë ekstremitet e poshtme e deri te momenti kur këto ekstremitete janë liruar plotësisht, kjo frikë cilësohet si frikë nga përfundimi fatal apo nga vdekja. Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur rreth 24 orë, si pasojë e reaksionit akut në strese e përcjellur me ankthe, reagime të forta emocionale dhe frikë nga invaliditeti i mundshëm. Frika sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur rreth 2 muaj, fillimisht me vështërsi rreth adaptimit në kushte të trajtimit spitalor ku hyn periudhat operative, përpunimi i plagës, trajtimet dhe tretmanët e shumta mjekësore, gjendje kjo që te i dëmtuari ka shkaktuar iritabilitet, zgjimet e shpeshta gjatë natës për shkak të pozitës së detyruar në shtrat, ulje të pragut të tolerancës, ulje të vullnetit të disponimit dhe shqetësim se mos këto pasoja do të mbesin për tërë jetën (bazuar edhe në moshën e re të të dëmtuarit). Frika sekondarë e intensitetit të ulët, vazhdon ende, herë pas here me qenë se i njëjti ende ndien probleme dhe dhembje në ekstremitete të poshtme gjatë funksionimit të përgjithshëm jetësor si dhe gjatë aktiviteteve reaktive dhe sportive, kjo e bënë që të rikujtojë momentin e aksidentit të ndiej ankth dhe pasiguri për gjendjen e tij shëndetësore, ku edhe kësaj ekspertize ia fali besimin në tërësi, pasi që e njëjta është e punuar në mënyrë profesionale dhe ka përshkruar në mënyrë të detajuar gjendjen e këtu paditësit. Vlen të ceket se për këtë ekspertizë nuk ka pasur vërejtje e as kundërshtime nga ana e palëve ndërgjyqëse.

Andaj të gjitha këto e kanë bindur gjykatën që të vendos sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi pika (a) duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, pasi që shumat e aprovuara janë në përputhje të plotë me lëndimet e pësuar nga paditësi.

Lidhur me kërkesën e paditëses që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur që paditësit në emër të ndihmës së personit të tretë t'ia paguaj shumën prej 800.00 euro dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 250.00 euro, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pika (b) duke i aprovuar pjesërisht kërkesat e të njëjtit, pasi që kjo gjykatë i vlerëson si të pranueshme për nga baza, duke marr për bazë kohëzgjatjen e nevojës për përkujdesjen e personit të tretë, si dhe për ushqimin e përforcuar të nevojshëm të konstatuar në ekspertizë mjekësore për paditësin, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njeh rastet e tilla të kompensimit. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj, ushqim të përforcuar (sikurse në ekspertizë), të njëjtës ligjërisht i takon ky lloj dëmi i kërkuar dhe në shumat e vlerësuara nga ana e gjykatës.

Ekspertët përkatës kanë vlerësuar se lëndimi i paditësit është lëndim e cila karakterizohet si lëndim i karakterit të rëndë trupor. Andaj, edhe lartësia e shumës së të

hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarit-paditësit, satisfaksion që ai të jetë në gjendje t'i kompenzojë të mirat jo materiale dhe materiale nga të cilat është privuar, e kjo duke marr parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, moshën e të dëmtuarit, intensitetin e dhimbjeve, frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit, lëndimin e përshkruar më hollësisht në ekspertizën e ekspertëve përkatës, të cilat i kemi përmendur më lartë, gjykata ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet në emër të fitimit të humbur gjykata vendosi konform dispozitave të nenit 179 të LMD-së dhe duke u bazuar në mendimet e ekspertëve të lartcekur dhe vendosi që për periudhën e kaluar nga data 01.01.2015 (data prej kur i është ndërprerë paga nga punëdhënësi) deri më 31.07.2023, në shumën prej 34,739.00 euro, kurse renta për periudhën e ardhshme prej 01.08.2023, deri sa për këtë të egzistojnë kushtet ligjore në shumën prej 400.00 euro në muaj, rentën për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese gjykata vendosi të paguhet në çdo muaj dhe jo në shumë të përgjithshme (kapitalizuar), pasi që kjo për rastin konkret është më e arsyeshme dhe e domosdoshme për paditësin. Gjykata lartësinë e fitimit të humbur e ka gjykuar duke marrë për bazë ekspertizën e përpiluar nga ekspertët mjekësor Dr. S.U. ortoped-traumatolog dhe Dr. V.B.R. psikiatër, ku kanë përcaktuar se paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të punës në shkallën prej 22%, po ashtu ekspertizën për vlerësimin e aftësisë së punës e ekspertit Dr. A.H. i cili ka përcaktuar se në gjashtë muajt e parë pas aksidentit paaftësia për punë e paditëses ka qenë 100% për çdo lloj pune, për gjashtë mujorine e dytë bazuar në sanimin e disa pasojave, pa aftësia për punë mund të ketë qenë 50% për punën e vet, pas vitit të dytë e tutje pa aftësia për punë është tani që është cekur 30%, si dhe nga ekspertiza e ekspertit aktuar prof. A.B. si dhe plotësimi i ekspertizave e datave 07.03.2017 dhe asaj plotësuese të datës 16.05.2017 dhe nga dëgjimi i tij në procesverbalin e datës 10.11.2023, andaj gjykata i ka marrë të besueshme ekspertizat, të cilat pasqyrojnë gjendjen faktike dhe reale të paditësit. Sipas vlerësimit të gjykatës renta në formë të kapitalizuar mund të caktohet vetëm në rastet kur pala e cila ka obligim që të paguajë rentën (debitori) nuk e ofron shumën të cilën e cakton gjykata, apo kur ka të dhëna se pala e paditur është pranë shuarjes (person juridik) dhe nuk ka mundësi që të paguajë në të ardhmen, atëherë pala paditëse (kreditori) mund të kërkojë që e njëjta ti paguhet në një shumë të përgjithshme (kapitalizuar). Po ashtu në favor të kësaj shkon edhe fakti se renta e caktuar mund të ndryshohet varësisht nga ndryshmi i rrethanave lidhur me ecurinë e rastit konkret.

Pra përfundimisht gjykata vlerëson se deri te aksidenti kishte ardhur për shkak se në makinën Handle Kollergang Typ HKS 1966, ishin realizuar intervenime në kundërshtim me manuelet/udhëzuesit e prodhuesit Handle&Sohn, të cilat intervenime i referohen furnizimit me energji elektrike të derës së makinës së punës përmes një urëzimi jo profesional që kishte për pasojë eliminimin e funksionimit të sensorit i cili

kontrollon automatikisht hapjen/mbylljen e derës së kësaj makine dhe me këtë sigurinë në punë gjatë përdorimit, i cili fakt është konstatuar në supereksperzitën e grupit të ekspertëve e mbështetur edhe në konstatimet e ekspertit A.K. dhe ekspertit Hamdid Nuredini si dhe shikimit në vend të ngjarjes të cilët kanë dhënë mendimin e përbashkët përkitazi me shkakun determinant të këtij incidenti në punë e që i referohet dështimit e mirëmbajtjes së makinës së punës e që përgjegjësia kryesore bie mbi punëdhënësin.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, Gjykata mbi bazën e vlerësimit të të gjitha kritereve dhe masave për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material dhe vlerësimit të ekspertizave, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke gjykuar vlerën e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit, të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi duke refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit dhe atë për frikë shumë prej 500.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë 2,000.00 euro, për ndihmën e personit të tretë shumë prej 100.00 euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 50.00 euro, si dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimaterik shumë prej 560.00 euro, ngase konsideroi se shumatat e kërkuara mbi shumatat e aprovuara si në pikën I të dispozitivit janë të larta dhe nuk i përgjigjen lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi në aksident dhe të gjitha rrethanave tjera të cilat janë me rëndësi për vlerësimin dhe caktimin e kompensimit.. Gjykata në asnjë mënyrë nuk e përjashton mundësinë që paditësi të ketë krijuar shpenzime të caktuara përgjatë shërimit të tij, si pasojë e aksidentit në fjalë, megjithatë për këtë pjesë të kërkesëpadisë së tij, gjykatës nuk i është dorëzuar e as parashtruar asnjë provë valide eventuale.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës, të njëjtat sipas vlerësimit të gjykatës janë të pabazuara, për shkak se ato më tepër janë të orientuara drejtë rrjedhës së procedurës se sa në drejtim të paraqitjes fakteve lidhur me objektin e kontestit.

Në lidhje me kumatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar për dëmin jo material dhe material, me kumatë prej 8%, krejt kjo duke u bazuar në nenin 382 parag. dhe 2 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me nr.265/2020, të datës 02.12.2020, pjesa e tretë pika XIV, Gjykata për dëmin material vendosi që kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë datë 18.04.2016, ndërsa kamata për dëmin jo material fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (datë 02.02.2024) duke u bazuar në mendimin juridik të lartcekur pika XV.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike kontestimore.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat nenit 449, 452.1 dhe 463 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 208.00 euro, përfaqësimi për 6 seanca nga 270.40 euro (6x270.40) në shumë të përgjithshme prej 1,622.40 euro në kontestin C.nr.373/16, përfaqësimi për 10 seanca nga 270.40 euro (10x270.40) në shumë të përgjithshme prej 2,704.00 euro në kontestin C.nr.1525/20, shpenzimet e ekspertizave e mjekësore në shumë prej 300.00 euro, shpenzimet e ekspertizës mjekësore nga lëmia e punës në shumë prej 150.00 euro, shpenzimet e ekspertizës aktuaristike dhe plotësimi në shumë prej 450.00 euro, për taksë gjyqësore për padi 250.00 euro, respektivisht shumë të tërësishme të shpenzimeve prej **5,684.40** euro. Ndërsa gjykata gjeti se sipas rregullores për tarifat e avokatëve për kontestet me vlerë prej 10,000 euro e më lartë lartësia e shpenzimeve për përpilimin e padisë është 208.00 euro, e jo 406.25 euro siç ka kërkuar i autorizuari i palës paditëse, andaj gjykata për këtë arsye refuzoi diferencën prej 198.25 euro, po ashtu sipas rregullores për tarifat e avokatëve për kontestet me vlerë prej 10,000 euro e më lartë lartësia e shpenzimeve për përfaqësim është 270.40 euro, e jo 422.50 euro siç ka kërkuar i autorizuari i palës paditëse, andaj gjykata për këtë arsye për përfaqësim në seanca në kontestin C.nr.373/16, refuzoi diferencën prej 912.60 euro, kurse në kontestin C.nr. 1525/20 refuzoi diferencën prej 1,521.00 euro, gjykata e ka refuzuar edhe shumë prej 422.50 euro për seancën gjyqësore të datës 16.06.2023 pasi që me këtë datë sipas shkresave të lëndës nuk është mbajtur seanca, po ashtu janë refuzuar shpenzimet e udhëtimit për shkak se i autorizuari i paditësit gjykatës nuk i ka ofruar ndonjë provë (faturë, kupon fiskal) lidhur me këto shpenzimet, në fund gjykata i refuzoi edhe shpenzimet për azhurnimin e çështjes/shqyrtimin e lëndës në shumë prej 380.00 euro si dhe për taksën për aktgjykim në shumë prej 250.00 euro, pasi të njëjtat kërkesa nuk i konsideroj të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq (neni 453, paragrafi 1 i LPK-së).

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1525/2020, me datë 02.02.2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate Themelore.